

KËRKESË
Nr. 5121/1, datë 16.5.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga realizimi i projektit, “Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen ‘Loni Dhamo’, Lushnjë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive prone private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pasurinë e llojit “ndërtesë” (garazh), për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

- Vlera totale e shpronësimit është 400,297 (katërqind mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

Lista paraprake e pronarit të pasurive, prone private, që shpronësohen nga realizimi i projektit
“Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen ‘Loni Dhamo’, Lushnjë”
Vlerësimi për objektet është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000

Nr.	Emër mbiemër	Lloji i pasurisë	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. totale m ²	Sip. e shpronësuar m ²	Vlera e ndërtesës	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Sajmir Ali Kurti	Ndërtesë (garazh)	8572	5/44-Nd	20	20	400,297.00	400,297.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnjë, me shkresën nr. 5064/1 prot., datë 5.7.2018
Vlera totale paraprake					20		400,297	400,297	